

FJALA E DEPUTETES EVIS KUSHI

E ENJTE 14 KORRIK 2022

E nderuar Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Projektligji i parqeve teknologjike dhe shkencore është një domosdoshmëri për kohën, kur zhvillimet e vrullshme të teknologjisë janë pasuar me transformime rrënjësore në shumë sektorë. Ai paraqet një kuadër konceptual dhe organizativ për krijimin e parqeve, me përqasje të inkubatorëve të biznesit dhe me fokus rrisë dhe idetë inovative. Ka studime që paraqesin përvojat dhe praktikat më të mira të parqeve teknologjike dhe shkencore në vende si Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Izrael, ku këto modele janë implementuar qysh herët, ndoshta që në vitet '60-të, dhe na tregojnë rrugën më të mirë se si mund të zbulojmë talentet, të nxisim idetë inovative dhe të mbështesim bizneset, në mënyrë që të krijojmë shanse për të rinjtë tanë, si dhe t'u japim atyre mundësinë për ta kaluar butë tranzicionin nga shkolla drejt tregut të punës.

Unë nuk dua të përsëris ato çfarë thanë kolegët për qëllimin dhe avantazhet e ligjit në tërësi, por si ministre e Arsimit, që në fushën e përgjegjësisë kam edhe kërkimin shkencor, dua të vlerësoj lidhjen që ka ky projektligj me shtyllën apo misionin e tretë të universiteteve, që është transferimi i njohurive përtej mjediseve akademike, për të dhënë me shumë kontribut në zhvillimin social, kulturor dhe ekonomik të komuniteteve. Para pak ditësh nënshkruam një marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin "Aldo Moro" të Italisë, në Bari dhe Qendrën Ndërkombëtare për Studime Agronomike Mesdhetare të Barit, si dhe 5 universitete publike shqiptare, marrëveshje e cila ka në fokus pikërisht këtë: nxitjen e bashkëpunimit midis universiteteve dhe industrisë, por edhe pjesëmarrjen në projekte, konferenca dhe aktivitete të përbashkëta kërkimore-shkencore.

E përmenda këtë rast, sepse do të ishte shumë e dobishme që, nëpërmjet këtij projektligji ne të hapim rrugën që struktura të tilla të nxitjes së kërkimit shkencor dhe zhvillimit të teknologjive të reja të ndërtohen përreth universiteteve tona. Kjo do të siguronte që studentët e diplomuar ose ato në proces diplomimi të aksesonin praktikat mësimore nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërmjet universiteteve dhe bizneseve, që do të zhvillohen në këto parqe; do të siguronte gjithashtu, akses të biznesit në objektet universitare dhe teknologjitë, duke respektuar procedurat, veçanërisht ato të pronësisë intelektuale; do të siguronte përdorimin kontraktual të pajisjeve, laboratorëve, pajisjeve dhe teknologjitë e inxhinierisë dhe informatikës, ku një shembull shumë i mirë është Fakulteti i Shkencave të Natyrës, me një laborator modern, bashkëkohor që i shpërben jo vetëm Universitetit të Tiranës, por edhe universiteteve të tjerave në vend, ashtu sikurse bizneseve në Shqipëri dhe në të gjithë rajonin.

Kjo do të krijonte edhe mundësi për bizneset, që të marrin oferta trajnimi dhe edukimi të personalizuar ose akses në ofertat e arsimit të rregullt dhe të vazhdueshëm në universitet, si dhe mundësi punësimi në pozicione ndihmëse të universiteteve për punonjësit e parqeve teknologjike. Nga ana tjetër, universitetet do të mund të siguronin shërbime që ofrojnë mbështetje në fusha të ndryshme si: planifikimi shkencor, inxhinierik, financiar, tatimor, menaxherial, por edhe shërbime të tjera. Mbështetur në modelet më të përparuar, ashtu siç është sanksionuar edhe në këtë projektligj, parqet me qendër universitetin marrin mbështetje nga shteti nëpërmjet buxhetit të dedikuar për programet e kërkimit dhe inovacionit, ato të nxitjes së biznesit të vogël dhe ndihmës shtetërore, në formën e financimit të drejtpërdrejtë të kërkimit dhe zhvillimit, të iniciativave të teknologjisë së lartë, si dhe stimuj të tjerë tatimorë.

Një park me bazë universitare, sigurisht që mund të ndihmojë në transferimin e produktit kërkimor-shkencor dhe atij laboratorik në përdorime për industrinë. Megjithatë, ajo që është shumë e rëndësishme për suksesin e çdo parku shkencor apo teknologjik, është zgjedhja e një hapësire tregtare, në të cilën parku mund të zhvillojë avantazhin konkurrues, në bazë të talentit njerëzor dhe atij profesional.

Të nderuar kolegë, Zhvillimet e vrullshme që po ndodhin sot në teknologji ne po i reflektojmë në politikat tona të reja në arsimin parauniversitar, duke futur gjuhën angleze që në klasë të

parë, ICT-në dhe kodim në klasë të parë, pilotim në 100 shkolla për kurrikulën e re, por edhe për smart lab-et me teknologji të avancuar, projekt pilot për inteligjencën artificiale, ashtu sikurse edhe projekti “Shkollat e shekullit XXI” që nxisin mendimin kritik, mendimin krijues te nxënësit dhe të rinjtë.

Të gjitha këto që përmenda kanë për qëllim përgatitjen e brezit të ri me aftësi që u përgjigjen kërkesave, tendencave të reja të kohës, zhvillimeve teknologjike dhe nevojave të tregut të punës. Për sa me sipër, ju ftoj ta votojmë këtë projektligj. Faleminderit!